



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë-Ministarstvo Trgovine i Industrije-Ministry of Trade and Industry

Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA)
Agencija za Investicije i Podršku Preduzeča na Kosovu (KIESA)
Kosovo Investment and Enterprise Support Agency (KIESA)

Me qëllim të promovimit të eksportit dhe turizmit në Kosovë, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë “(MTI)” përmes Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (“KIESA”), shpallë:

**Thirrje publike për subvencionim të projekteve të subjekteve që
kontribuojnë në promovimin e eksportit dhe promovimin e
potencialeve turistike të Kosovës**

Bazuar në prioritetet e MTI-së në përkrahje të kompanive prodhuese me potencial eksportues dhe promovimin e potencialeve turistike të Kosovës, MTI-KIESA bazuar në Udhëzimin Administrativ MTI nr. 03/2016 për Ndarjen e Mjeteve Financiare nga Kategoria Ekonomike e Subvencioneve dhe Transfereve (“UA MTI 03/2016”) dhe mandatin e saj shpall thirrje publike për përkrahjen e subjekteve të cilat janë të regjistruara në Republikën e Kosovë dhe të cilat me projekt-propozime dëshmojnë që subvencionet e ndara do të ndikojnë në a) rritjen e eksportit ose b) promovimin e turizmit. Vlera totale e subvencionimit nga MTI-KIESA për vitin 2017 është 30.000,00 euro.

Për secilin aktivitet që do të subvencionohet nga MTI-KIESA, do të lidhet marrëveshje me subjektin përfitues dhe MTI-KIESA ruan të drejtën e rishikimit dhe të ndryshimit të të gjitha elementeve të projekt-propozimeve duke përfshirë, por pa u kufizuar në: kohën e realizimit, buxhetin, pjesëmarrësit, bashkëorganizatorët, ekzpozimin mediatik, branding-un, etj.

Zërat e shpenzimeve të cilat i mbulon MTI-KIESA janë shpenzimet e qirasë së hapësirës ekspozuese/promovuese dhe shpenzimet e ndërtimit të shtandit. Subjektet kanë të drejtë të aplikojnë me më së shumti tri (3) projekt-propozime të cilat përfshijnë periudhën e realizimit maj-nëntor 2017. Vlerësimi i aplikacioneve për ndarjen e mjeteve nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere do të bëhet sipas UA MTI 03/2016. Vlera maksimale e mëbshtetjes së një projekt-propozimi është 25.000,00 euro.

1. Për të aplikuar duhet plotësuar:
 - 1.1. Aplikacionin me të dhënat bazike të subjektit aplikues,
 - 1.2. Deklaratën nën betim dhe

- 1.3. Listën e dokumenteve të kërkuara.
2. Kriteret e përgjithshme dhe dokumentet e domosdoshme për aplikim:
 - 2.1. Subjektet që aplikojnë për subvencione dhe transfere në Ministri, duhet të jenë të regjistruara në Republikën e Kosovës,
 - 2.2. Projekt-propozimin që përfshin qëllimin dhe aktivitetet e projektit,
 - 2.3. Koston financiare si dhe planin kohor të realizimit të projektit,
 - 2.4. Listën e përfituesve potencial,
 - 2.5. Përshkrimin e detajuar të kapaciteteve menaxhuese dhe teknike të subjektit,
 - 2.6. Dëshminë e xhirollogarisë aktive në njërën prej bankave të licencuara nga Banka Qendrore e Kosovës,
 - 2.7. Vërtetimin nga Gjykata që dëshmon që personi i autorizuar i subjektit, nuk është nën hetime,
 - 2.8. Kopjen e letërnjoftimit të personit të autorizuar të subjektit dhe
 - 2.9. Raportin mbi gjendjen financiare të subjektit. Subjektet fillestare duhet të paraqesin vetëm planin e biznesit.
3. Kriteret e vlerësimit:
 - 3.1. Numri i aktiviteteve të ngjashme të organizuara pesë (5) vitet e fundit nga subjekti aplikues të dëshmuara me marrëveshje, kontrata, ekspozim në media, etj. Një (1) pikë për secilin aktivitet, maksimum 10 pikë;
 - 3.2. Numri i ndërmarrjeve pjesëmarrëse në aktivitet. Një (1) pikë për secilën ndërmarrje, maksimum 10 pikë;
 - 3.3. Përqindja e gjithsej shpenzimeve të projekt-propozimit që mbulohen nga subjekti aplikues. Një (1) pikë për çdo 5% të shpenzimeve të mbuluara nga subjekti aplikues, maksimum 20 pikë;
 - 3.4. Përqindja e të punësuarve nën moshën 40 vjeçare nga gjithsej të punësuarit e subjektit aplikues të dëshmuar me kontratë të punës, kopje të dokumentit identifikues, pasqyrën e kontributeve në Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës (TRUSTi), etj. Një (1) pikë për çdo 25% të të punësuarve nën moshën 40 vjeçare nga gjithsej numri i të punësuarve të subjektit aplikues, maksimum katër (4) pikë;
 - 3.5. Përqindja e të punësuarve të gjinisë femrore nga gjithsej të punësuarit e subjektit aplikues të dëshmuar me kontratë të punës, kopje të dokumentit identifikues, pasqyrën e kontributeve në Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës (TRUSTi), etj. Një (1) pikë për çdo 25% të grave të punësuar nga gjithsej numri i të punësuarve të subjektit aplikues, maksimum katër (4) pikë;
 - 3.6. Përqindja e të punësuarve nga komunitet jo-shumië nga gjithsej të punësuarit e subjektit aplikues të dëshmuar me kontratë të punës, kopje të dokumentit identifikues, pasqyrën e kontributeve në Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës (TRUSTi), etj. Një (1) pikë për çdo 50% të të punësuarve nga komunitetet jo-shumicë nga gjithsej numri i të punësuarve të subjektit aplikues, maksimum dy (2) pikë;

Ndërmarrjet që do të vlerësohen me më pak se 25 pikë do të diskualifikohen.

Dëshmitë për kriteret e sipërpërmendura duhen siguruar nga aplikuesit paraprakisht nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, Administrata Tatimore e Kosovës, Dogana e Kosovës, Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës (TRUSTi) dhe institucionet tjera relevante.

Njoftimi për thirrje publike është i publikuar në ueb faqen e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë mti.rks-gov.net. Subjektet që dëshirojnë të aplikojnë sipas thirrjes publike duhet të

shprehin interesimin e tyre duke dorëzuar të gjithë dokumentacionin përkatës në formë fizike në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, Rr. Muharrem Fejza, Lagjja e Spitalit, p. n. Prishtinë, 10000, Republika e Kosovës dhe në formë elektronike në adresën info.kiesa@rks-gov.net

Afati i fundit për shprehje të interesit është deri me datë 11.08.2017 në orën 16:00. Projekt-propozimet e dorëzuara pas afatit kohor nuk do të merrën parasysh.

Në momentin e aplikimit subjekti pranon të gjitha përgjegjësitë, obligimet, kriteret dhe detyrat e parapara me UA MTI 03/2016.

Informata dhe sqarime shtesë mund të merren përmes postës elektronike info.kiesa@rks-gov.net.